Për: z. Fitim Krasniqi – Sekretar Permanent i Zyrës së Kryeministrit (ZKM);

Zyrës Ligjore të ZKM-së

Agjencionin Kundër Korrupsionit-Departamenti i Parandalimit-Divizioni i Parandalimit të Konfliktit të Interesit

Cc: z. Ramadan Sejdiu –Drejtor: Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike NJPMNP/MZHE

Bordin e Drejtorëve(Kryesuesin dhe Anëtarët)-Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK), SHA

Nga: Hamdi Aliu, Tel: 044/257 458

**Lënda: Ankesë ndaj Vendimit te Bordit te KMDK-se,Nr. 28/11 të dates 30.09.2011, mbi Anulimin e Vendimit te Bordit te KMDK-se,Nr.27/11 të datës 22.09.2011**

Bazuar në konkursin e datës 04.07.2011,të shpallur nga Bordi i Drejtorëve i Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK) SH.A, për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv. Në këtë konkurs kamë konkuruar me datë 28.07.2011, Shiko dokumentet,me numër protokoli 11/353, KMDK

Bordi i Drejtorëve të KMDK-se SH. A. me datë:22.09.2011 ka bërë intervistimin e kanditatëve të selektuar, sipas proceduarave te parapara ligjore. Pas intervistimit jam Emëruar/Përzgjedhur në pozitën e Kryeshefit si kandidati më i poentuar për poziten e Kryeshefit Ekzekutiv(K.E), te KMDK-se, SHA-(NP-Qëndrore), me seli Prishtinë

I referohem Vendimit te Bordit të Drejtorëve i nënshkruar nga Kryesuesi, Asllan Vitaku, me numër të protokolit 27/11 i datës:22.09.2011 dhe Nr:19/09-11, te KMDM Sh. A. Vendim në pajtueshmëri me konkursin, intervistimin, poentimin dhe me Ligjin për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087 të nenit 21. Me datë 26.09.2011, zyrtarisht nga kompetentet e KMDK-së, kamë marrë konfirmimin dhe kam pranuar Vendimin (atachment) Nr.27/11 te datës:22.09.2011 dhe Nr:19/09-11, te KMDK-së

KMDK SH.A Dalëse ☒ Hyrëse ☐
Nr: 11/327
13.10.11

Sh. A. Per përzgjedhjen time si KE nga Sekretarja e Ndërmarjes dhe më është kërkuar që nga data 01 Tetor 2011, te filloj punen si KE, ne KMDK.

Shiko-Vendimi: Nr.27/11 i datës:22.09.2011, i Bordit te Drejtorëve të KMDM-se, pika 2 thotë: Hamdi Aliu, do filloj punën nga data 01.10.2011 dhe duke parë se vendimi nuk kishte pikë të paraparë të ankimimit apo keshillë juridike për ankesë/a, pra bazuar ne vendimin për përzgjedhjen time për Kryeshef, sipas procedures, kam Njoftuar Drejtorinë(kolektivin) e Shkollës,ku kam punuar në Arsim, se nga 01.10.2011, jam angazhuar me pune diku tjeter.

Me datë 30.09.2011, 10h paradite, Sekretarja e Ndërmarjes më ka njoftuar përmes telefonit(celularit) se gjatë kësaj periudhe ka pasur një ankesë nga një kandidatë i intervistuar dhe Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 30.09.2011 ka marrë Vendimin, nr.28/11(Nr:20/09-11), për Anulimin e vendimit të datës 22.09.2011 me numër 27/11(Nr:19/09-11) për përzgjedhjen time si Kryeshef Ekzekutiv i KMDK-së dhe po në të njejtën mbledhje të jashtëzakonshme Bordi i Drejtorëve ka marrë vendim Nr.29/11(21/09-11) për emërimin e kandidatit të radhës nga lista për Kryeshef Egzekutiv, pra ka emëruar një kandidat tjetër?! Për të gjitha këto proceduara, ankesa dhe vendime, unë si KE i emëruar, më datën 22.09.2011, jam njoftuar me 30.09.2011(me telefon)?!

Andaj bazuar në Ligjin për Nderrmarrje Publike Nr.03/L-087, duke ju referuar nenit/eve:

Neni 17: Kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale, i kemi plotësuar të gjitha kushtet e parapara me konkurs ne te gjitha aspektet profesionale;

Neni 17.2 Të gjith drejtorët përveq Kryeshefit Egzekutiv duhet të jenë të pavaruar, pra ky nen gjegjësisht pika(k), që i referohet Vendimi i BD-së, i datës 30.09.2011, nr 28/11, konsiderojmë se vlenë për Anëtarët e Bordit gjegjësisht(Drejtorët joegzekutiv), sepse neni 17.2 decidivisht thotë: Të gjith drejtorët përveq Kryeshefit Egzekutiv KE-së duhet të jenë të pavaruar, pra neni 17.2 pika(k), nuk vlenë për KE-në, sepse KE, përzgjedhet përmes konkursit dhe nga Bordi i

Drejtorëve, sipas nenit 21 zgjedhja dhe emërimi i zyrtarëve të NP-së bëhet nga Bordi i NP-së (Andaj ju kerkojmë që ti referoheni apo interpretoni nenet: 21; 21.1 ;21.2 dhe neni 21.3, thotë: Secila NP do të ketë këta katër zyrtar të lartë: (1) Kryeshefin Egzekutiv;(2) Zyrtarin Kryesor Finaciar;(3) Këshilltarin e përgjithshëm/Sekretarin/en Korporativ/e dhe (4) Zyrtarin për Auditim të Brendshëm. Pra neni 23.3 Këto pozita i parashef si zyrtar te lartë dhe jo si Drejtor Joegzekutiv dhe neni 17.2 pika(k) vlenë për Anëtarët e Bordit e jo per zyrtarët që zgjidhen me konkurs sipas nenit 21 te LNP-se pra sipas kualifikimit.

Bazuar në nenet e potencuara më lartë, konsiderojmë se Emërtimet/Pozitat dhe termet, Drejtor i referohen anëtarëve të BD-së(Drejtorëve Joegzekutiv), kurse Kryeshef Egzekutiv, Zyrtar i lartë i referohen zyrtarëve që zgjidhen apo emërohen me konkurs dhe sipas kualifikimit.

Duke ju referuar Ligjit për Nderrmarrje Publike Nr.03/L-087, respektivisht nenit 21.4:

"Për përzgjedhjen e personave për emërim si zyrtarë të NP-së, Bordi i Drejtorëve duhet të Kryejë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese e cila ka për qëllim që të gjitha Emërimet të bëhen ekskluzivisht në bazë të meritës. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të Gjithë personat e emëruar si zyrtarë të jenë persona me integritet të njohur të cilët (i) i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas Nenit 17; 17.1, 17.2 i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, Të gjith drejtorët përveq Kryeshefit Egzekutiv duhet të jenë të pavaruar.

Neni 3 Pronësia

Neni 3.1 Thotë: Të gjitha ndërmarrjet e radhitura në listën 1 e cila i është bashkangjitur LNP-së, janë ndërmarrje qëndrore. Të gjitha NP-të Qëndrore janë në pronësi të Republikes së Kosoves dhe Qeveria e Republikes se Kosoves është Aksionare apo pronare 100%, siq është edhe KMDK-ja, SHA;

Kurse neni 3.2 Thotë: Të gjitha ndërmarrjet e radhitura në listën 2, të LNP-së, janë ndërmarrje lokale. Të gjitha Ndërmarrjet Lokale janë në pronësi të Komunes/Komunave.

Prandaj konsideroj që përzgjedhja ime si KE, ka qenë konform ligjit dhe proceduarve, sepse nuk kam pasur, nuk kam dhe nuk mund të kemë kurrfar konflikti të interesit lidhur me mengjimin e KMDK-së, vetem se jam kanë apo jam anëtar i kuvendit të Komunës(zv.kryesues i komuniteteve,per mbrojtjen e te drejtave dhe lirive te komuniteteve dhe qyetareve, ne rast se institucioni komunal i shkel, kjo eshte e rregulluar, me LVL anëtari i kuvendit të komunës nuk është vend pune), këtë e rregullon ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe kushtetuta e Republikes se Kosoves.

Asnjë herë nuk kam ushtruar apo nuk kam qenë bartës i postit udhëheqës apo vendimmarrës në ndonjë parti politike, kjo nuk qëndronë dhe mund të vertetohet!

Komunat menagjojnë me NP Lokale. Kurse Qeveria si aksionare përmes Bordit menagjon me ndërmarrjet Publike Qëndrore, në këtë rastë me KMDK-në

ARSYETIMI I ANKESËS

Duke u bazuar në ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087;

Bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve i nënshkruar nga Kryesuesi, Asllan Vitaku, me numër të protokolit 27/11 i datës:22.09.2011dhe Nr:19/09-11, te KMDM Sh.A. Vendimi nuk ka paraparë këshilla juridike?! Ku jam emëruar-përzgjedhur Kryeshef Egzekutiv i KMDK-së. Në pajtueshmëri me konkursin dhe me Ligjin për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087 të nenit 21;

Bazuar në Vendimin, nr.28/11(Nr:20/09-11),pika 2 Këshilla juridike:Pala e paknaqur ushtronë ankesë kundër këtij vendimi në afatin e paraparë tek organet kompetente. Parashtroj kundërshtim mbi Anulimin e vendimit të datës 22.09.2011 me numër 27/11(Nr:19/09-11) për përzgjedhjen time si Kryeshef Ekzekutiv i KMDK-së

Bazuar në Vendimin Nr.29/11 të datës 30.09.2011,bazuar te pika 3 dhe pika 4 e vendimit Nr.29/11, po në të njejtën mbledhje të jashtëzakonshme Bordi i Drejtorëve ka marrë vendim Nr.29/11(21/09-11) për emërimin e kandidatit të radhës nga lista për Kryeshef Egzekutiv, pra ka emëruar një kandidat tjetër?!

Bazuar në argumentet e parashtruara më lartë, si palë e pakënaqur parashtroj/bëjë Ankesë dhe Konsiderojë që Anulimi i Vendimit për emërimin tim si KE, nga Bordi i Drejtorëve nuk ka bazë(qartësi) juridike për arsye se: Në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me numër të protokolit 27/11 i datës:22.09.2011 dhe Nr:19/09-1,te KMDM-së Sh. A. Vendimi nuk ka paraparë këshilla juridike?! Ku jam emëruar-përzgjedhur Kryeshef Egzekutiv i KMDK-së, kurse në Vendimin nr.28/11(Nr:20/09-11),pika 2 ka paraparë Këshilla juridike, për ankesë prej 30 ditësh, tek organi kompetent?! (nuk është potencuar tek cili apo tek cilat organe) sikurse në Vendimin Nr.29/11, pika 4 ka paraparë këshill juridike, për ankesë në afat prej 30 ditësh, tek organi kompetent?!

(nuk është potencuar tek cili apo tek cilat organe), ku konsiderojmë se këshilla nuk ka qenë e qartë?

Bordi Drejtorëve pohon në Vendimin nr.28/11(Nr:20/09-11) se ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 21.4 dhe 17.2 të Ligjit për Nderrmarrje Publike Nr.03/L-087, si më poshtë

Duke ju referuar Ligjit për Nderrmarrje Publike Nr.03/L-087, respektivisht nenit 21.4: Për përzgjedhjen e personave për emërim si zyrtarë të NP-së,Qëndrore Bordi i Drejtorëve duhet të kryjë një procedurë të hapur,transparente dhe konkurruese e cila ka për qëllim që të gjitha emërimet të bëhen ekskluzivisht në bazë të meritës. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjithë personat e emëruar si zyrtarë të jenë persona me integritet të njohur të cilët (i) i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas Nenit 17.1, (ii) i plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2,

Neni 21.4 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) dhe (iii) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; *me kusht që*(i) Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit të posedojë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e Financave dhe/ose kontabilitetit; (ii) Këshilltari i Përgjithshëm / Sekretari i Korporatës të Posedojë diplomë universitare në ligj dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e

Qeverisjes korporative ose të drejtësisë të shoqërive tregtare; dhe (iii) Zyrtari për Auditim të Brendshëm të jetë person ekspert në kontabilitet.

Neni 17.2 ku thuhet: Të gjithë drejtorët përveç KE duhet të jenë të pavarur.

- Duke referuar nenin 21.4 dhe nenit 17.2. te LNP shifet qarte se vendimi i parë i BD-së per emrimin tim ka qene i drejt dhe ka pasur baze ligjore .
- Konsideroj se Bordi i Drejtorëve nuk mund të jetë në të njejtën kohë në cilësin e panelit për vlerësim të zgjedhjes së Kryeshefit Ekzekutiv dhe njëkohësishtë të rishqyrtoj anuloj vendimin e vetë apo të shqyrtojë ankesën e kandidatit potencial – sikurse ka ndodhur?!
- Organi shqyrtues i ankesës mendoj se duhet të jetë zyra ligjore e Kryeministrisë që është organi më i lartë dhe perfaqesues I pronarit(aksionarit) te Ndërmarrjes. Andaj me të njejtin vendim Bordi i Drejtorëve ka treguar se ka bërë shkelje ligjore duke lejuar në autoritetin e tyre si organ përfaqësues i aksionarit të bëjë edhe zgjedhjen edhe shqyrtimin e ankesës që tejkalon kompetencat dhe autoritetin që posedon Bordi i Drejtorëve;
- Si kandidatë i zgjedhur dhe i emëruar me vendim të Bordit pasi jam informuar dhe kam pranuar Vendimin mbi emërimin tim si KE (përmes emailit) me datën 26.09.2011 nga ana e kompetentes/ sekretares së Ndërmarrjes,jamë njoftuar se jam përzgjedhur/emëruar Kryeshef i KMDK-së;
- Unë kam informuar punëdhënësin tim të mëparshëm(Udhëheqësinë e shkolles), dhe kam paralajmëruar/kërkuar, ndërprerjen e punes nga ana ime si punëtor i arsimit, ku jam i dëmtuar materialisht,nga paga ne arsim dhe shpenzimet e konkurimit etj, jam lënduar personalisht, moralisht dhe me është degraduar personaliteti dhe integriteti im, pasi vendimi për emërimin tim ishte bërë publik;
- Duke besuar në autoritetin e organeve kompetente për këtë qështje, të zyrës ligjore pranë Zyrës së Kryeministrisë(ZL-ZKM) si autoritet legjitim për interpretimin e ligjeve,akteve nën ligjore, statuteve dhe rregulloreve, për shqyrtimin e ankesave, në këtë rastë të ankesës sime, shpresoj që ankesa

ime do të shqyrtohet dhe vendoset, në mënyrë të drejtë, profesionale dhe ligjore në afatin e paraparë;

- Si paarshtrues i Ankesës (palë apo person më i dëmtuar në këtë rast), kërkoj që organet kompetente që i adresohet kjo Ankesë, në përgjithësi dhe Zyra Ligjore e ZKM-së, në veqanti(interpretues i ligjeve dhe përfaqësues i aksionarit, të vendos lidhur me ligjshmërinë, pra të shfuqizoj-Anuloj, 2 Vendimet BD-së,së KMDK-së (Nr.28/11& 29/11) te mbledhjes së jashtzakonshme, të datës 30.09.2011 të Bordit gjegjësisht të rikthehet – fuqizohet ligjshmërisht, Vendimi Nr.27/11 , i Bordit të KMDK-së, i mbledhjes së rregullt të datës 22.09.2011. Pra kërkojmë që vendimi i parë me Nr.27/11 i Bordit për Emërimin-Përzgjedhjen time të mbetet legjitim.

  Mbesim me shpresë se Ankesa/Parashtresa ime do shqyrtohet nga organet kompetente dhe do vendoset konform proceduarave ligjore dhe administrative.

Ankesës i bashkangjes:

Vendimin Bordit te KMDK-së te Dt.22.09/2011, Nr.27/11

Vendimin e Bordit te KMDK-së, Dt.30.09/2011, Nr.28/11

Vendimin e Bordit te KMDK-së, Dt.30.09/2011, Nr.29/11

Letrën e Kushteve të Konkursit,te publikuar me 04.07.2011, ne baze te Vendimit te Bordit, Dt:29.06.2011

Dokumente tjera nese janë te nevojshme

PARASHTRUESI I ANKESËS: Prof.Hamdi Aliu

Kandidat i përzgjedhur/Emëruar për pozitën e Kryeshefit egzekutiv të KMDK-së Me vendimin e Dt: 22/09/2011 te Bordit te KMDK-së, Nr 27/11-Vendim ky i Anuluar me Dt:30.09.2011, nga i njeti Bord i KMDK-së, me Nr:28/11

Date 12.10.2011 Prishtinë

KMDK SH.A
Dalëse
Hyrëse
Nr: 11/327
Data: 13.10.11
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A
Kosovo Landfill Management Company J.S.C.